



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 673/1 Prot.

Elbasan, datë 09 / 02 /2026

MIRATOHET
KRYETARI

z.Gledian LLATJA

PROGRAMI I SIGURIMIT DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË (PSPC)

Sigurimi i cilësisë së auditimit përfshin identifikimin dhe menaxhimin sistematik të aktiviteteve të nevojshme për të përmbushur objektivat e cilësisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Arritja e përmirësimeve domethënëse të cilësisë kërkon një qasje të koordinuar, që përfshin të gjithë funksionin e auditimit, pasi përpjekjet individuale, qoftë nga një auditues apo nga grupet e auditimit, janë të pamjaftueshme më vete. Nuk ka zgjidhje të shpejta për arritjen e cilësisë së auditimit. Drejtuesi i Njësisë së Auditimit duhet të miratojë një qasje metodike dhe të organizuar për të adresuar çështjet e cilësisë në mënyrë efektive. Ndërsa lindin sfida të reja në mënyrë të pashmangshme, ruajtja e cilësisë së auditimit kërkon një angazhim të vazhdueshëm dhe proaktiv për përmirësim.

XI.1 Qëllimi dhe Objektivat e PSPC

1. PSPC hartohet për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të funksionit të auditimit të brendshëm, duke siguruar përputhshmëri me pritjet e palëve të interesuara, duke arritur nivelin më të lartë të qeverisjes dhe duke përmbushur kërkesat e Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm 2024 (SGAB) të IIA-s.
2. Fushëveprimi i PSPC shtrihet përtej aktiviteteve të auditimit, duke përfshirë të gjitha aspektet e funksionit të auditimit të brendshëm. Ai siguron që auditimet e brendshme jo vetëm t'i përmbahen standardeve të përcaktuara, por edhe të ofrojnë vlerë nëpërmjet adresimit të risqeve organizative, duke përmirësuar qeverisjen dhe performancën.
3. PSPC konsiderohet të jetë një faktor kyç për funksionin e NJAB-së dhe synon të përmirësojë vazhdimisht performancën në planin afatgjatë duke u përqendruar në punën e auditimit, duke adresuar njëkohësisht nevojat e të gjitha palëve të tjera të interesuara. Është thelbësore që Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm të krijojë dhe zbatojë politika dhe procedura të miratuara për menaxhim efektiv, siguri dhe kontroll të cilësisë. PSPC hartohet për t'i ofruar siguri menaxhimit të lartë drejtues se shërbimet e ofruara do të përmbushin vazhdimisht standardet e kërkuara të cilësisë.
4. Objektivat e PSPC përfshijnë:
 - a. Sigurimin e përputhshmërisë me Standardet IAB dhe pajtueshmërinë me legjislacionin.
 - b. Vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të auditimit të brendshëm.
 - c. Promovimin e përmirësimin e vazhdueshëm për të përmbushur dhe tejkaluar pritshmëritë e palëve të interesuara.
 - d. Përputhjen me fokusin e SGAB në auditimin e bazuar në parime, duke përfshirë riskun, qeverisjen dhe sigurinë.

XI.2. Korniza e PSPC

Korniza e Programit të Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë përfshin një sërë standardesh të ndryshme si më poshtë:

Standardi SGAB	Titulli i Standardeve	Interpretim
8.3	Cilësia	Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të zhvillojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë që mbulon të gjitha aspektet e funksionit të auditimit të brendshëm. Programi përfshin dy lloje vlerësimesh: <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimet e jashtme. • Vlerësimet e brendshme.
8.4	Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë	Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet një herë çdo pesë vite nga një vlerësues i kualifikuar, i pavarur ose ekip vlerësuesish.
9.3	Metodologjitë	Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të vlerësojë efektivitetin e metodologjisë dhe përditësimin e tyre si të nevojshëm për përmirësimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe përgjigjet ndaj ndryshimeve të rëndësishme që ndikojnë në funksion.
12.1	Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë	Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të zhvillojë dhe të kryejë vlerësime të brendshme të përputhshmërisë së funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe ta çojë përpara drejt objektivave të performancës. Drejtuesi i NJAB duhet të krijojë një metodologji për vlerësimet e brendshme, siç përshkruhet në Standardin 8.3. Cilësia që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorim i vazhdueshëm i përputhshmërisë së funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet dhe progresit drejt objektivave të performancës. ▪ Vetëvlerësime periodike ose vlerësime nga persona të tjerë brenda njësisë publike me njohuri të mjaftueshme të praktikave të auditimit të brendshëm për të vlerësuar përputhshmërinë me Standardet.
12.2	Matja e Performancës	Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të zhvillojë objektiva për të vlerësuar performancën e funksionit të auditimit të brendshëm. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të marrë në konsideratë kontributin dhe pritshmëritë e këshillit mbikqyres dhe menaxhimit të lartë kur zhvillon objektivat e performancës. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të zhvillojë një metodologji të matjes së performancës për të vlerësuar progresin drejt arritjes së objektivave të funksionit dhe për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të funksionit të auditimit të brendshëm .

XI.3. VLERËSIM I BRENDSHËM I CILËSISË

1. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe kryejë vlerësime të brendshme të përputhshmërisë së funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe progresin drejt objektivave të performancës
2. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të hartojë procedura për vlerësimet e brendshme të cilësisë⁶¹, që përfshijnë:
 - Monitorimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë së funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet dhe progresin drejt objektivave të performancës.
 - Vetëvlerësimet ose vlerësimet periodike nga persona të tjerë brenda njësisë publike me njohuri të mjaftueshme të praktikave të auditimit të brendshëm për të vlerësuar përputhshmërinë me Standardet.
 - Komunikimin me **Kryetarin të Bashkisë/ Titullarin** për rezultatet e vlerësimeve të brendshme.
3. Bazuar në rezultatet e vetëvlerësimeve periodike, Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë plane veprimi për të adresuar rastet e mospërputhjes me Standardet dhe mundësitë për përmirësim, duke përfshirë një afat kohor të propozuar për veprime.
4. Vlerësimet e brendshme duhet të dokumentohen dhe të përfshihen në vlerësimin e kryer nga struktura përgjegjëse për harmonizimit e auditimit të brendshëm, si pjesë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së njësisë publike⁶². Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet t'i komunikojë **Kryetarin të Bashkisë/ Titullarin** rezultatet e vetëvlerësimeve periodike dhe planeve të veprimit⁶³.
5. Nëse mospërputhja me standardet ndikon në qëllimin ose funksionimin e përgjithshëm të funksionit të auditimit të brendshëm, Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet t'i raportojë **Kryetarin të Bashkisë/ Titullarin** mospërputhjen dhe ndikimin e saj.

XI.3.1. Monitorim i vazhdueshëm

6. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm është përgjegjës për të siguruar që aktiviteti i auditimit të brendshëm kryen një vlerësim të brendshëm që përfshin si monitorim të vazhdueshëm ashtu edhe vetëvlerësime periodike. Vetëvlerësimet periodike trajtojnë përputhshmërinë me çdo standard, ndërsa monitorimi i vazhdueshëm mund të përqendrohet në standardet përkatëse për kryerjen e angazhimeve.
7. Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të ketë parasysh, që vlerësimet e brendshme përqendrohen në përmirësimin e vazhdueshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe përfshijnë monitorimin e efikasitetit dhe efektivitetit të tij. Si pjesë e vlerësimit të brendshëm përmendim:
 - *Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së aktivitetit të auditimit të brendshëm; dhe*

⁶¹ Standardin 8.3 të Cilësisë

⁶² Standardin 8.4 Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë.

⁶³ Standardet 8.1 Ndërveprimi i këshillit mbikqyrës, 8.3 Cilësia dhe 9.3 Metodologjitë.

- *Vetëvlerësime periodike* mund të kryhen nga audituesi me më shumë përvojë në njësi, një ekip i dedikuar i sigurimit të cilësisë (nëse ka strukturë të tillë).
8. Monitorimi i vazhdueshëm përfshin mbikëqyrjen, rishikimin dhe matjen e përditshme të funksionit të auditimit të brendshëm. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të përfshijë monitorimin e vazhdueshëm në politikat dhe praktikat rutinë të përdorura për të menaxhuar funksionin e auditimit të brendshëm dhe përdorin procese, mjete dhe informacione të konsideruara të nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë me Standardet.
9. Monitorimi i vazhdueshëm kryhet nga:
- Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
 - Audituesit e brendshëm të Njësisë së Auditimit të Brendshëm brenda njësisë publike (sipas rolit që kanë ne Grupin e Auditimit)
10. Programi i sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit duhet të përfshijë mbikëqyrjen e angazhimit që fillon me planifikimin dhe vazhdon gjatë gjithë angazhimit. Mbikëqyrja përfshin vendosjen e pritshmërive, nxitjen e komunikimit ndërmjet anëtarëve të grupit gjatë gjithë angazhimit dhe rishikimin dhe nënshkrimin në kohë të letrave të punës⁶⁴.
11. Mekanizmat që përdoren zakonisht për monitorim të vazhdueshëm përfshijnë:
- Listat e kontrollit për të ofruar siguri mbi pajtueshmërinë e audituesve të brendshëm me praktikat dhe procedurat e përcaktuara dhe për të siguruar qëndrueshmëri në zbatimin e standardeve globale të auditimit të brendshëm.
Formate të sugjeruara të listës së kontrolleve për monitorim të vazhdueshëm, paraqiten sipas Formatin Standard nr.18 dhe nr.19 në Aneksin 3.
 - Reagime nga subjekti i audituar dhe palët e tjera të interesuara në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e grupit të auditimit të brendshëm duke përdorur Formatin Standard nr. 20 në Aneksin nr. 3.
 - Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP). Vendosja dhe monitorimi i treguesve specifike të performancës është thelbësore për vlerësimin e cilësisë dhe efikasitetit të funksionit të auditimit të brendshëm, sipas Formatit Standard nr. 1 në Aneksin nr. 4.
 - Matje të tjera që mund të jenë të vlefshme në përcaktimin e efikasitetit dhe efektivitetit të aktivitetit të auditimit të brendshëm. Matjet e buxheteve të projekteve, sistemet e llogaritjes së kohës mund të ndihmojnë në përcaktimin nëse shpenzohet sasia e duhur e kohës për të gjitha aspektet e angazhimit të auditimit. Ndryshimi i buxhetit me atë aktual mund të jetë gjithashtu një matje e vlefshme për të përcaktuar efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm.

⁶⁴ Standardin 12.3 Mbikëqyrja dhe Përmirësimi i Performancës së Angazhimit

XI.3.2. Vetëvlerësime ose vlerësime periodike

1. Vetëvlerësimet periodike ose vlerësimet periodike janë ndërtuar për të vlerësuar përputhshmërinë e funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe progresin drejt objektivave të performancës, kartës së auditimit të brendshëm, kërkesave rregullatore dhe efikasitetin dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm në përmbushjen e objektivave të auditimit dhe nevojave të **Kryetarit të Bashkisë/ Titullarit** të Njesisë Publike.
2. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të hartojë PSPC me qasje sistematike dhe të disiplinuar për procesin periodik të vetëvlerësimit, me qëllim që t'i ofrojë NJAB-së dhe **Kryetarit të Bashkisë/ Titullarit** të njesisë publike informacionin e duhur në lidhje me pajtueshmërinë e NJAB-së me SGAB.
3. Vetë-vlerësimet periodike kryhen nga auditues të brendshëm (pjesë e NJAB) që kanë marrë titullin Auditues i Brendshëm i Certifikuar (të njohur nga Ligji për AB) ose kanë përvojë të gjerë me standardet e AB ose një Grup i ngarkuar për sigurimin e cilësisë. Drejtuesi i auditimit të brendshëm, duhet të marrë në konsideratë përfshirjen e audituesve të brendshëm në procesin periodik të vetëvlerësimit për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për standardet.
4. Mjeti kryesor i përdorur për vetëvlerësim janë Listat e Kontrollit, sipas Fomatit Standard nr. 2 Aneksi 4 dhe Fomatit nr.2/1 në Aneksin 4 Drejtuesi i auditimit të brendshëm mund të përdorë anketimin si një mënyrë e dobishme për të mbledhur më shumë të dhëna mbi aktivitetin që do të vlerësohet.
5. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të sigurojë që në çdo rast, audituesi i brendshëm dhe/ose Grupi i ngarkuar me vetëvlerësimin e cilësisë të jetë i pavarur nga dosjet që shqyrtojnë (ata nuk duhet të vlerësojnë angazhimet për të cilat kanë qenë pjesë). Drejtuesi i NJAB duhet të marrë në konsideratë cenimet e mundshme të pavarësisë së vlerësuesve të nxitura nga marrëdhëniet e kaluara, të tashme ose të parashikuara në të ardhmen me njësinë publike, personelin e saj ose funksionin e saj të auditimit të brendshëm.
6. Vetëvlerësimet periodike vlerësojnë:
 - Përshtatshmërinë e metodologjive të funksionit të auditimit të brendshëm.
 - Sa e mbështet funksioni i auditimit të brendshëm arritjen e objektivave të njesisë publike.
 - Cilësinë e shërbimeve të kryera të auditimit të brendshëm dhe mbikëqyrjen e ofruar.
 - Shkallën në të cilën pritshmëritë e **Kryetarit të Bashkisë/ Titullarit** janë përmbushur dhe objektivat e performancës janë arritur.
7. Një proces periodik i vetëvlerësimit përfshin:
 - Mbikëqyrjen e angazhimeve ose misionëve të auditimit të brendshëm;
 - Plotësimin e listave të kontrollit të përcaktuara;
 - Përmbledhjen e reagimeve nga njësitet e audituara dhe palët e tjera të interesuara përmes intervistave dhe anketave;
 - Rishikime selektive të dokumenteve të punës nga kolegët që nuk janë përfshirë në auditimet përkatëse;

- Rishikimi i llogaritjes së kohës, përfundimit të planit të auditimit;
- Analiza e treguesve të performancës;
- Krahasimi i praktikave aktuale të njësisë së AB-së me praktikat më të mira të auditimit të brendshëm.

8. Duke iu referuar kërkesave të standardeve për komunikim efektiv me **Kryetarit të Bashkisë/ Titullarit**, Komitetin e Auditimit (nëse ka), Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të organizojë një vetëvlerësim periodik, të paktën **një herë në vit** për të gjithë funksionin. Një qasje e tillë ofron një bazë vjetore sigurie se puna e auditimit të brendshëm vazhdon të funksionojë në përputhje me kërkesat e SGAB dhe parimet e funksionit të auditimit të brendshëm.

XI.3.3. Treguesit Kryesorë të Performancës

9. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë objektiva për të vlerësuar performancën e funksionit të auditimit të brendshëm duke marrë parasysh të dhënat dhe pritshmëritë e **Kryetarit të Bashkisë/ Titullarit** gjatë zhvillimit të objektivave të performancës.

10. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë procedura të matjes së performancës për të vlerësuar progresin drejt arritjes së objektivave të funksionit dhe për të promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të funksionit të auditimit të brendshëm. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë një plan veprimi për të adresuar çështjet dhe mundësitë për përmirësim.

11. Kur përcaktohen objektivat e performancës duhet të marrë në konsideratë rezultatet e dëshiruara të artikuluara brenda:

- Parimeve të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm.
- Kartës së auditimit të brendshëm.
- Strategjisë së funksionit të auditimit të brendshëm.

12. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet mund të identifikojë objektiva të performancës, të cilat i raportohen **Kryetarit të Bashkisë /Titullarit**, përfshirë :

- Pritshmëritë e palëve të interesuara;
- Përputhshmëria me objektivat e njësisë publike;
- Nevojat për burime njerëzore;
- Efikasiteti financiar dhe operacional;
- Mësimi dhe zhvillimi profesional.

13. Pasi të jenë identifikuar objektivat e performancës, Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të vendosë objektiva të matshëm, si në aspektin sasior ashtu edhe cilësor, për të ndjekur progresin drejt përmbushjes së tyre si dhe të pëcakttojë teknika për të vlerësuar periodikisht saktësinë e të dhënave të raportuara dhe për të përmirësuar vazhdimisht pritshmëritë e performancës.

14. Drejtuesi i auditimit të brendshëm harton Planet e veprimit për të adresuar çështjet dhe mundësitë që lidhen me arritjen e objektivave të performancës dhe ia komunikon **Kryetarit të Bashkisë /Titullarit**.

15. Kur përcaktohen objektivat dhe masat e performancës, mund të merren në konsideratë kategoritë e mëposhtme:

Pasi të jenë identifikuar objektivat e performancës, Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të vendosë objektiva të matshëm, si në aspektin sasior ashtu edhe cilësor, për të ndjekur progresin drejt përbushjes së tyre si dhe të përcaktojë teknika për të vlerësuar periodikisht saktësinë e të dhënave të raportuara dhe për të përmirësuar vazhdimisht pritshmëritë e performancës.

16. Drejtuesi i auditimit të brendshëm harton Planet e veprimit për të adresuar çështjet dhe mundësitë që lidhen me arritjen e objektivave të performancës dhe ia komunikon **Kryetarit të Bashkisë /Titullarit**.

17. Kur përcaktohen objektivat dhe masat e performancës, mund të merren në konsideratë kategoritë e mëposhtme:

- **Mbulimi i objektivave të angazhimit**, që pritet të shqyrtohen sipas mandatit të auditimit të brendshëm.
- **Adresimi i objektivave të rëndësishëm të njësisë publike**, përmes opinionit të përgjithshëm të auditimit në nivel të njësisë publike.
- **Përqindja e rekomandimeve ose planeve të veprimit të zbatuara nga menaxhimi**, që çojnë në rezultate të dëshiruara dhe monitorohen nga funksioni i auditimit të brendshëm.

18. Formati Standard nr.1 në Aneksin 4 përfshin, por nuk kufizohet në Listën e treguesve të Performancës së funksionit të auditimit të brendshëm që duhet të jenë pjesë e PSPC.

XI.3.4. Vlerësimet e jashtme të cilësisë

19. Vlerësimet e jashtme të cilësisë së NJAB-ve në Sektorin Publik kryhen nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas metodologjisë së miratuar nga Ministri përgjegjës i financave.

20. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë NJAB, si mëposhtë:

- të paktën një herë në 5 vjet;
- në bazë të një procesi të përzgjedhjes nga vlerësimi i riskut;
- në bazë të ankesave të pranuar;
- në bazë të çështjeve të ngritura në media ose;
- në bazë të kërkesës së vetë NJAB.

XI.2. Raportimi dhe komunikimi i vlerësimit të cilësisë të auditimit të brendshëm

21. Drejtuesi i auditimit të brendshëm, jo më pak se një herë në vit, duhet t'ia komunikojë rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë **Kryetarit të Bashkisë/ Titullarit**. Rezultatet e vlerësimeve të jashtme të cilësisë duhet të raportohen në çdo rast me përfundimin dhe marrjen e raportit përfundimtar të vlerësimit. Në të dyja rastet, komunikime të tilla përfshijnë:

- Përputhjen e funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet dhe arritjen e objektivave të performancës.
- Fushëveprimin, frekuencat dhe rezultatet e vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme të cilësisë, të kryera nën drejtimin ose me ndihmën e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm.
- Plane veprimi që adresojnë mangësitë dhe mundësitë për përmirësim.
- Progresin drejt përfundimit të veprimeve të dakordësuara.

- Nëse është e aplikueshme, përputhshmërinë me ligjet dhe/ose rregulloret që lidhen me auditimin e brendshëm.
- Nëse është e aplikueshme, planifikon të adresojë mangësitë dhe mundësitë për përmirësim të funksionit të auditimit të brendshëm.

22. Pas miratimit nga **Kryetari të Bashkisë /Titullarit**, PSPC dërgohet në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Konceptoi:

Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm
Qemal TUSHA